



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Për: KB.Rahoveci
C.C. Federata e Basketbollit të Kosovës
Lënda:Ankesa
Nga : Komesari Garave
Vendi: Prishtinë , 18.10.2019

Të nderuar,

Ju njoftoj se pas përfundimit të ndeshjes së mbetur të xhiros së II në mes Feronikelit vs Rahovecit 75:72 e zhvilluar më 16.10.2019 , me nënshkrimin e kapitenit Rron Grapci në procesverbal dhe deponimin e shumës prej 500 euro KB Rahoveci ka përmbushur kriteret për të paraqitur ankesë konform Nenit 42 të Propozicioneve të Garave. Duke i shqyrtuar të gjitha materialet, deklaratat e gjyqtarëve, incizimin e ndeshjes, rregullat e basketbollit 2018 Neni 9.8 citoj : Kur Tabela është e pajisur me LED ndriqimin për skadim të kohës së ndeshjes, ky ndriqim ka prioritet ndaj sinjalit të kohës për lojë, interpretimi i rregullave të basketbollit për shfrytëzimin e IRS te rasti i anulimit të shënimit në fund të çerekut të katërt dhe Konform Nenit 42.10 te PG duke kërkuar ekspertize nga antarët e SHGJFBK-së, Komesari i Garave ka marrë këtë :

VENDIM

Pas verifikimit të provave, rregullave të basketbollit 2018 dhe konform Nenit 42.4 , 42.6 ,42.7 dhe 42.10 të Propozicioneve të Garave, Komesari Garave ndeshjen e lartëcekur e rregjistron me rezultatin e aritur 75;72 ne favor të KB Feronikeli.

Kosovo Basketball Federation, Lagjja "Arbëria", Bloku C3/(Faza 2), Rr. Radovan Zogoviq, Hyrja 7 10000 Prishtinë,
Kosovë
www.basketbolli.com, email: federata@basketbolli.com, mob: +386 49 738 080



TEB



RUGOVE



bakertilly





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

KËSHILLË JURIDIKE

KB Rahoveci ka të drejtën e ankesës ndaj vendimit të Komesarit të Garave drejtuar Komisionit Arbitrar të FBK-së e cila duhet të dorëzohet më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit.

Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 500.00 €.

Ankesa e cila nuk është dorëzuar me kohë tek Komisioni Arbitrar, apo nuk është deponuar shuma e caktuar refuzohet dhe nuk do të shqyrtohet.

Ky vendim i është dërguar KB.Rahoveci, KB.Feronikeli, Arkivës së Federates së Basketbollit të Kosovës.

Me respekt
Komesari Garave
Faton Kurshumlija



Kosovo Basketball Federation, Lagjja "Arbëria", Bloku C3/(Faza 2), Rr. Radovan Zogoviq, Hyrja 7 10000 Prishtinë,
Kosovë

www.basketbolli.com, email: federata@basketbolli.com, mob: +386 49 738 080



TEB



RUGOVE



bakertilly

